

Njoftim për shtyp
datë 01/12/2023

Në institucionin e Avokatit të Popullit u zhvilluan mbledhjet e Komisionit Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e shoqërisë civile.

Pjesëmarrësit në mbledhje ishin, z. Gentjan Sejrani Kryetar, z. Rigels Xhemollari sekretar, z. Eduart Mazi, anëtar, znj. Ada Ilia, anëtare dhe z. Arbër Ademi, anëtar.

Të pranishëm në mbledhjet, me statusin e vëzhguesit ishin gjithashtu përfaqësuesit nga misioni OPDAT në Shqipëri, EU4Justice, OSCE dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Pas shqyrtimit të dosjes së kandidatës Rezarta Abdiu, Komisioni duke vlerësuar informacionet e dosjeve dhe informacionet shtesë nga vetë kandidatët Komisioni vendosi:

1. Konstatimin e mosplotësisë të kushteve ligjore për kandidaten Rezarta Abdiu.
2. Vendimi i arsyetuar do i dërgohet brenda një afati të arsyeshëm.

Këtu përfundon edhe procesi i verifikimit të kriterëve formale ligjore për kandidatët për anëtarë të KLP dhe KLGJ.

Mbledhja e radhës në intervistat me kandidatët e kualifikuar do të njoftohet në ditët në vijim.